

PKR.nr.878/13

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**, në përbërje nga kryetar i trupit gjykues Naser Foniqi, me sekretaren juridike **Sevdije Breznica**, si procesmbajtëse, në çështjen penale të akuzuarit F.M., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328, par. 1 të Kodit Penal të Kosovës, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë së Qarkut - tani Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda PP.nr.753-2/12, të datës 01.11.2012, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 14.05.2018, në të cilin ishin të pranishëm Prokurori i shtetit Valdet Gashi dhe i akuzuari F.M., pas shqyrtimit fillestar, të njëjtën ditë, me datë 14.05.2018, mori dhe publikisht, shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari F.M.**, i biri i A.1 dhe A.2, e vajzërisë R., i lindur me datë ..., në fshatin B., Komuna M., tani me banim në fshatin M. i E., Komuna O., ka të kryer tri klasë të shkollës fillore, i martuar- baba i tetë fëmijëve, pensionist-realizon pension në shumë prej ... **euro**, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

**S e p s e:** deri me datë 16.08.2012, në shtëpinë e tij, në fshatin M. i E., Komuna O., ka mbajtur armën Colt Voverment 1911 AI Tm kal. 9 mm P.A.K, me numër serik D8176604, me të cilën ka shtënë 7-8 herë në ajër, në ahengun – dasmën (fejesën e djalit), dhe e cila armë është sekuestruar nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës, e për të cilën nuk ka poseduar lejen e organeve kompetente për posedimin e armës,-

- me këtë, ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328, par. 1 të KPK.

Prandaj gjykata në bazë të neneve: 34; 41; 42; 43; 44; 64; 328, par. 1 dhe 5, të KPK, si dhe nenit 365, të KPPK, i shqipton:

**DËNIM ME GJOBË ME KUSHT**

Në shumë prej **gjashtëqind (600) €**, i cili nuk do të ekzekutohet në afat prej **një (1) viti**, në qoftë se **i akuzuari F.M.**, gjatë kësaj kohe nuk do të kryej veprë të re penale.

- Obligohet i akuzuari që t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **njëqind (100.00) €**, në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.
- Të akuzuarit i i konfiskohet pistoleta e markës Colt Voverment 1911 AI Tm kal. 9 mm P.A.K, me numër serik D8176604, e cila është përdorur për kryerjen e veprës penale.

## A R S Y E T I M I

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën PP.nr.753-2/12, të datës 01.11.2012, e ka akuzuar të pandehurin F.M., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328, par. 1 të KPK.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, të datës 14.05.2018, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari F.M., ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, si dhe ka shtuar se këtë armë e ka pasur kujtim nga djali i tij, i cili i ka vdekur në vitin 2000 dhe se arma ka qenë me gaz, përkatësisht nuk ka qenë e rrezikshme. Po ashtu, i akuzuari ka theksuar se nga pensioni në shumë prej ... euro, ka një kredi në këste prej ... euro për çdo muaj.

Sa i përket pranimin të fajësisë nga i pandehuri, Prokurori i Shtetit, ka deklaruar se i akuzuari e ka pranuar fajësinë pasi që më parë e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit dhe se ky pranim është bërë vullnetarisht, pasi që ka kuptuar qartë dhe drejt aktakuzën. Andaj, prokurori i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë nga i akuzuari me qenë se ky pranim është bërë konform dispozitave ligjore të nenit 248 të KPPK, pastaj të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit, ndërsa me rastin e matjes së dënimit të ketë parasysh si rrethana lehtësuese pranimin e fajit nga i akuzuari dhe ta ketë parasysh moshën e tij.

Pas deklarimit të të pandehurit se ndihet fajtorë për kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar nga Prokuroria, trupi gjykues me aktvendim ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, po ashtu ky pranim është bërë vullnetarisht dhe është mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza.

Po ashtu, edhe nga shkresat e lëndës, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale **Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328, par. 1 të KPK**, si dhe vërtetoi gjendjen faktike, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata edhe e shpalli fajtorë të akuzuarin, pasi që më parë gjeti se është penalisht përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese si: intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur; sinqeritetin e treguar gjatë shqyrtimit; rrethanat në të cilat është kryer vepra penale; pranimin e fajit për veprën e kryer penale; rrethanat personale të kryesit dhe gjendjen e tij ekonomike, si dhe moshën e të akuzuarit, ndërsa gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese, prandaj të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën edhe është shpallur fajtorë, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar kundër tij,

do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin **34, të KPK**, përkatësisht të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëj rehabilitimin e tyre, të parandaloi persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat penale dhe të shprehë

gjykimin shoqëror për veprën penale, për ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 453, par. 1, të KPPK.

Vendimi që të pandehurit t'i merret sendi i përdorur për kryerjen e veprës penale, u mor në bazë të nenit 328, par. 5, të KPK.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 365, të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 14.05.2018.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA  
PKR.nr.878/13, datë 14.05.2018.

Sekretare juridike,  
**Sevdije Breznica**

---

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari,  
Naser Foniqi

---

**UDHËZIMI JURIDIK:**

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.